



UNIVERSITETI I TIRANËS

SENATI AKADEMIK

Sheshi "Nënë Tereza", Rektorati i UT, Tiranë
Tel. +4 2228402. Fax: +4 2223981

VENDIM Nr. 53, datë 29/05/ 2014

“Miratim i qëndrimit të strukturave të Universitetit të Tiranës, për Reformën në Arsimin e Lartë”

Senati i Universitetit të Tiranës, i mbledhur në dt. 29.05.2014, pasi u njoh me qëndrimet e mbajtura nga departamentet, këshillat e fakulteteve dhe strukturat studentore, si dhe nga diskutimet e zhvilluara në këtë mbledhje:

VENDOSI

1. Senati Akademi i UT-së vlerëson me përgjegjësi të madhe nismën për një reformim të Arsimit të Lartë dhe shpreh bindjen se është i nevojshëm një reformim i plotë si në aspektin struktural, kurrikular ashtu edhe në atë të organizimit dhe financimit.
2. Ai vlerëson nismën e Qeverisë se reforma kaq të rëndësishme të diskutohen me grupet e interesit dhe të kryhen në bashkëpunim me to.
3. Mbështetur në qëndrimet e fakulteteve dhe strukturave studentore, Senati Akademik i UT-së shprehet se meqënëse drafti i propozuar, nuk i përmbush kërkesat për një reformë të plotë të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, duhet domosdoshmërisht të pasqyrojë propozimet e grupeve të interesit në fazat e tjera të reformës.

4. Për të përgatitur një projekt/ligj me standarde evropiane, i sugjerojmë komisionit përkatës dhe MAS që në themel të ligjit të ri të Arsimit të Lartë, të jenë propozimet e Raportit të Shoqatës Evropiane të Ligjit, Arsimit dhe Politikës të kryesuar nga Prof. J. De. Groof, të përgatitur për ligjin aktual të Arsimit të Lartë.
5. Senati i UT-së kërkon që e njëjta procedurë e ndjekur për raportin e parë, duhet të realizohet dhe për raportin e dytë dhe sidomos për projekt/ligjin që do të përgatitet, në mënyrë që strukturat e universiteteve të shprehin qëndrimet e tyre, duke i lënë kohën e nevojshme në dispozicion këtij drafti.
6. Para se drafti i projekt/ligjit të futet në procedurat e miratimit institucional, t'i kërkohet një vlerësim Shoqatës Evropiane të Ligjit, Arsimit dhe Politikës.
7. Senati Akademik i UT, shpreh vullnetin e vet për të kontribuar me të gjitha kapacitetet e tij, në mënyrë që ligji i ardhshëm të realizojë plotësisht autonominë universitare të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
8. Senati vendosi që qëndrimet e ardhura në mënyrë institucionale nga fakultetet dhe strukturat studentore, t'i përcjellë në MAS së bashku dhe me Rekomandimet e Grupit të Ekspertëve të Këshillit të Evropës.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. DHORI KULE